


VOTA JUAJ,



ZËRI JUAJ

# TË GJITHË JEMI TË BARABARTË

ALISA (12), AULONA (13), ARLINDI (13), FLORIANI (13)



## Lexues të dashur, nga ne sot do të mësoni se pse është e rëndësishme të jetojmë në një shtet demokratik

Të jetosh në demokraci do të thotë të jesh i lirë, të shprehësh mendimin tënd lirshëm, të jetosh në paqe dhe të jesh i barabartë si të gjithë të tjerët. Fjala demokraci rrjedh nga greqishtja e lashtë që ekziston prej vitit 507 p.e.s dhe kuptimi i kësaj fjale është qeverisje e popullit. Populli qeveris me anë të votave. Të drejtën e votës në Republikën e Kosovës, e kemi nga moshën 18 vjeçare, sepse jemi më të pjekur dhe dijmë më mirë se kë duhet ta votojmë. Demokracia ndahet në dy lloje të cilat janë: demokracia e drejtpërdrejtë e cila është e pranishme në vendet të cilat kanë numër më të vogël të popullsisë dhe demokracia përfaqësuese e cila është e pranishme në shtetet të cilat kanë numër më të madh të popullsisë.

Demokracia përfaqësuese ndahet në dy sisteme: si-


stemi parlamentar dhe sistemi presidencial. Kosova ka demokraci përfaqësuese me sistem parlamentar, sepse populli del dhe voton duke i zgjedhur kështu 120 deputetë të cilët kanë për detyrë ta përfaqësojnë popullin. Roli i popullit në një shtet demokratik është shumë esencial, sepse vet populli vendos për mënyrën e qeverisjes së vendit. Meqenëse populli iu jep votat deputetëve ata në Kuvend e zgjedhin Presidentin, po ashtu deputetët marrin pjesë edhe në procesin e votimeve të projektligjeve. Nëse një projektligj i caktuar merr shumicën e votave nga deputetët, ai projektligj bëhet ligj që hyn në zbatim nga Qeveria dhe përfitues është populli. Prandaj, qytetarë të dashur meqë keni vlerë shumë të madhe në qeverisjen e shtetit, respektoni sa më shumë elementet që përbëjnë demokracinë, sepse demokracia është sistemi më i mirë i qeverisjes. Bëhu pjesë e zhvillimit shtetëror, duke qenë sa më demokrat.



Të gjithë duam të jetojmë në paqe




Gazetarët e demokracisë



Projekti i demokracisë



Bashkëpunimi në grup



Betimi i deputetëve



Kushtetuta e Kosovës




Duke shkruar artikullin



Përpilimi i planit të grupit

## LIGJET, RREGULLAT QË DUHEN ZBATUAR

FAKETE (13), ALBIN (13), VALESA (13), ALTIN (13), FIONA (12)



### Ligjet miratohen në Kuvendin e Kosovës dhe si të tilla duhet të zbatohen nga të gjithë qytetarët e Kosovës pa asnjë dallim

Në çdo shtet ka disa institucione të cilat merret me interesat e qytetarëve. Një nga këto institucione që merret me interesat tona është Kuvendi i Republikës së Kosovës. Kuvendi i Kosovës ka tri funksione të cilat janë: funksioni përfaqësues, quhet kështu sepse ne jemi ata të cilët i zgjedhim deputetët. Për shembull ne në klasë e zgjedhim një kryetar, i cili na përfaqëson neve. Ai kryetar i mbron interesat tona si nxënës të cilët e përbëjmë atë klasë. Funksioni legjislativ, quhet kështu sepse në vendin tonë kemi një libër i cili quhet Kushtetutë. Ligjet të cilat miratohen nga deputetët duhet të përputhen me nenet të cilat janë të shkruara në atë libër. Para se të miratohen ato quhen projektligje, pastaj kur ato shqyrtohen nga komisionet e Kuvendit dhe miratohen nga votat e deputetëve quhen ligje. P.sh. secili nxënës nëpër shtëpitë e veta ka rregulla të

cilat duhet zbatuar. Ne në shtëpinë tonë nuk kemi të drejtë të hudhim mbeturina, sepse kjo gjë e dëmton ambientin i cili ndikon negativisht në shëndetin tonë. Ne duhet t'i ndajmë mbeturinat e qelqit në një shportë dhe mbeturinat ushqimore në një shportë tjetër. Funksioni tjetër i Kuvendit është edhe funksioni i kontrollit. Quhet kështu sepse deputetët e zgjedhin Kryeministrin (udhëheqësin e Qeverisë), prandaj ata duhet ta kontrollojnë punën që e bën Qeveria. Në klasën tonë nëse kryetari nuk e përfaqëson klasën si duhet ne kemi të drejtë të kundërshtojmë dhe ta largojmë nga pozita që ka. Kuvendi i Kosovës e përfaqëson shtetin dhe popullin, miraton, shfuqizon dhe propozon ligje të reja, mbikëqyr punën e Qeverisë e po ashtu zgjedh Qeverinë dhe Presidentin.

Të dashur lexues, ligjet të cilat janë të shkruara në Kushtetutë ne duhet t'i respektojmë dhe t'i zbatojmë ato. Ato ligje përfshijnë të drejtat e çdo qytetari pavarësisht nga gjinia, mosha, raca, etj.



Kushtetuta është akti më i lartë i një shteti



Gazetarët demokratë

# VOTA JONË SJELL NDRYSHIMIN

ALBINA (12), ABEDIN (12), AVDI (12), ERJONA (12), ILIRION (12)



**Demokracia, sistem ky që na ofron barazi, respekt, tolerancë, solidaritet e mbi të gjitha mundësin për të qenë vetvetja**

Zgjedhjet janë një ndër elementet më të rëndësishme të demokracisë, kjo sepse zgjedhjet janë ato që na mundësojnë të kemi një shtet demokratik.


Ne e dijmë që edhe në të kaluarën ka pasur zgjedhje, por jo kaq demokratike siç janë tani. Më parë, të drejtë për të votuar kanë pasur vetëm një pjesë e caktuar e shoqërisë, më saktësisht personat e gjinisë mashkullore dhe të pasurit. Ndërsa tani kanë të drejtë vote të gjithë, pa marrë parasysh gjininë, fenë, racën, etj.

Tani shumë gjëra kanë ndryshuar dhe gjëja më e rëndësishme është gjithëpërfshirja. Në filltet e demokracisë nuk kanë pasur të drejtë vote gratë, njerëzit e moshuar, personat me nevoja të veçanta, pra të drejtë vote kanë pasur vetëm njerëzit e pasur (fisnikët). Me kalimin e kohës edhe vet demokracia ka pë-

suar ndryshime, por ndryshime këto që janë shumë të mirëpritura. Tani edhe ne si fëmijë kemi shumë të drejtë që moshatarët tanë nuk i kanë gëzuar më parë. Kemi të drejtën e shkollimit e shumë të drejta të tjera. Pasi edhe vendi ynë, Kosova është vend demokratik sigurisht që zhvillon edhe zgjedhje demokratike. Populli ynë i zgjedh përfaqësuesit e vet në dy lloj zgjedhjesh, në ato lokale dhe qendrore.

Në zgjedhjet lokale populli voton për të zgjedhur kryetarin e komunës dhe asambleistët, mandati i të cilëve zgjat për katër vjet. Ndërsa në zgjedhjet qendrore populli voton për të zgjedhur deputetët të cilët e përfaqësojnë popullin.

Po ashtu edhe mandati i këtyre zgjat 4 vjet. Të drejtë për të zgjedhur e kemi pasur që nga lindja, por për të marrë pjesë në procesin zgjedhor kemi të drejtë nga moshë 18 vjeçare. Kjo sepse jemi më të rritur dhe mund të gjykojmë drejt se kush mund të udhëheq vendin më së miri dhe më së drejti.



Sepse ti mund të bësh ndryshimin



Bashkë, për një të ardhme më të ndritur



## IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI  
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA  
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



**ERSTE Stiftung**

Redaktohet nga  
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit  
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale  
shtypur nga  
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë: Pjesëmarrësit:  
Tel: +381 38 704 560 SHFMU „Gj.K.Skënderbeu“  
E-mail: info@demos-ti.org Klasa: VII  
Website: www.demos-ti.org Vendi: Vushtrri